



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova-Republic of Kosovo



**Komuna e Gjakovës**  
Opština Djakovica-Municipality of Gjakova

---

**RREGULLORE  
PËR  
SHËRBIMET PUBLIKE  
DHE  
RENDIN KOMUNAL**

**Korrik, 2018**



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO**  
**KOMUNA E GJAKOVËS**  
**OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA**



**Kuvendi i Komunës - Gjakovë**  
01 Nr.352101-22518 /2018  
Datë: 28.07.2018

Kuvendi i Komunës së Gjakovës në bazë të nenit 12 (paragrafi 12.1 dhe 12.2., shkronja c) dhe nenit 40 (paragrafi 40.1 dhe 40.2 shkronja a) të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 18 (paragrafi 18.1 dhe 18.2 shkronja a) të Statutit të Komunës së Gjakovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 28.07.2018, pas diskutimeve lidhur me pikën e 6 të rendit të ditës: Shqyrtimi i Draft Rregullores për Shërbimet Publike dhe Rendin Komunal, miratoj këtë:

**RREGULLORE**  
**PËR**  
**SHËRBIMET PUBLIKE DHE RENDIN KOMUNAL**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Rregullorja për Shërbime Publike dhe Rendin Komunal si qëllimi primar ka përmirësimin e kushteve jetësore të qytetarëve, mbrojtjes se sipërfaqeve publike dhe pamjes sa më të bukur të qytetit dhe vendbanimeve tjera.

**Neni 2**  
**Fushëveprimi**

Me këtë rregullore përcaktohen detyrat dhe obligimet e qytetarëve, ekonomive familjare, bashkësive të ndryshme, shoqatave, bizneseve, ndërmarrjeve private dhe publike, organeve të administrimit lokal si dhe subjekteve të tjera për mirëmbajtjen e higjienës në hapësirat publike, mbrojtjes se objekteve komunale dhe mbrojtjen e hapësirave publike, dispozitat mbikëqyrëse si dhe masat sankzionuese kundër të gjitha subjekteve që shkelin dispozitat e kësaj rregulllore.

**Neni 3**  
**Përkufizimet**

1. **“Komuna”** Komuna e Gjakovës, siç është parapare me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.
2. **“Subjekt”** Personi fizik ose juridik që merret ose jo me afarizëm.
3. **“Produkt”** Çdo mall/produkt, objekt statik ose lëvizës.
4. **“DPI”** Drejtorati për Punë Inspektuese në Komunën e Gjakovës.
5. **“Inspektor”** Inspektori i Shërbimeve Publike në Drejtorinë për Punë Inspektuese.

6. **"Sipërfaqe publike"** Sipërfaqet me rëndësi të përgjithshme për komunikacion që janë të shtruara dhe të pa shtruara, me zhavorr, kubëza, asfalt, sipërfaqet e gjelbërtë, varrezat etj., dhe të destinuara për qarkullimin apo qëndrimin e njerëzve, respektivisht lëvizjen e njerëzve dhe automjeteve të cilat mund të shfrytëzohen nga pjesëmarrësit në komunikacion dhe çdo sipërfaqe tjetër e cila është e definuar si e tillë nga organi kompetent.
7. **"Rregullore"** Rregullorja për Shërbimet Publike dhe Rendin Komunal.
8. **"Organji kompetent komunal"** Drejtori Komunal i cili në bazë të Statutit të Komunës së Gjakovës ose të ndonjë akti tjetër ligjor të veçantë është i autorizuar ti kryej punët e caktuara.
9. **"Objektet Komunale"** Të gjitha objektet e vendosura nga Komuna apo nën kompetencë të komunës e që shfrytëzohen nga qytetarët dhe të gjitha ato objekte të cilat sipas destinimit që kanë, mund të konsiderohen objekte/asete komunale.
10. **"Operatori Ekonomik"** Personi fizik, juridik apo ndërmarrja/kompania e cila është e autorizuar me ligj, kontraktuar apo i është besuar nga organi kompetent për kryerjen e punëve të caktuara.

#### Neni 4

##### Shërbimet komunale në vështrim të kësaj Rregullore konsiderohen

Mirëmbajtja, shfrytëzimi dhe rregullimi i sipërfaqeve publike, mirëmbajtja e pastërtisë në sipërfaqet publike, nyjet sanitare publike, bartja, deponimi dhe trajtimi i mbeturinave, përcjellja, trajtimi dhe pastrimi i ujërave të zeza dhe ujërave atmosferike, gjelbërimin, ndriçimi publik, tregjet, furnizimi me ujë-ujësjellësi, furnizimi i lagjeve me energji termike, rregullimi dhe mirëmbajtja e varrezave.

#### Neni 5

##### Shfrytëzimi i objekteve komunale

1. Të gjithë shfrytëzuesit e objekteve komunale, sipërfaqeve publike, respektivisht të gjithë ata të cilëve u janë dhënë objektet në qeverisje apo shfrytëzim, janë të detyruar që t'i mirëmbajnë dhe t'i shfrytëzojnë sipas kushteve të paraparë, duke pasur parasysh se pamja dhe gjendja e këtyre objekteve dhe sipërfaqeve publike duhet të jenë në funksion të pamjes sa më të bukur të qytetit dhe në harmoni me kriteret e vendosura nga organi kompetent komunal.
2. Çdo dhënie në shfrytëzim e sipërfaqeve publike nga organi kompetent, duhet të jetë për kohe të caktuar.
3. Ndalohet shfrytëzimi i të gjitha llojeve të mirave dhe i çfarëdo forme fitimi nga objektet publike pa pëlqim të organit kompetent, si dhe keqpërdorimi, dëmtimi, shkatërrimi, prerja, lakimi, ndotja etj., e të gjitha objekteve me interes të përgjithshëm, siç janë: kabina telefonit, ndriçimi publik, fidanët, shenjat e trafikut, shenjat tjera orientuese, objektet e parqeve, pajisjet sportive dhe të rekreacionit në sipërfaqet publike, të shkollave, foshnjorëve, stacioneve, objektet e ujësjellësit, kanalizimit, energjisë elektrike si dhe objekte të tjera që cilësohen si objekte komunale.
4. Cili do subjekt që i dëmon objektet komunale apo sipërfaqet e tjera publike, është i obliguar që brenda afatit të përcaktuar nga inspektori të kthej në gjendje të mëparshme, në të kundërtën këtë do ta bej operatori ekonomik pas kërkësës se inspektorit, shpenzimet për riparim/ndërrim dhe gjoba do ti vihen subjektit.

**Neni 6**  
**Mirëmbajtja dhe rregullimi i sipërfaqeve publike**

1. Organi kompetent apo operatori ekonomik i kontraktuar është i obliguar qe rrugët ti pajise me shenja dhe pajime të trafikut rrugorë sipas nevojës, dhe të bëjë mirëmbajtjen e tyre.
2. Urat, lëshesat, kanalet anësore për kullimin e ujërave atmosferike, shenjet e trafikut, tabelat tjera orientuese, barrierat etj., janë pjesë përbërëse të rrugëve lokale dhe askush nëkëto pjesë nuk guxon të ndërhyj pa pëlqim paraprak nga organi kompetent komunal
3. Sipërfaqet publike duhet të mirëmbahen dhe të janë në gjendje të rregullt dhe mund të shfrytëzohen vetëm në bazë të destinimit të tyre.
4. Mirëmbajtjen e sipërfaqeve publike është i obliguar ta kryej organi kompetent komunal apo operatori ekonomik i kontraktuar.

**Neni 7**  
**Shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e sipërfaqeve publike**

1. Ndalohet shfrytëzimi i rrugëve, trotuareve dhe sipërfaqeve tjera publike, transportimi i makinave ose mjeteve të tjera, që e dëmtojnë rrugën në çfarë do mënyre, pa pëlqim të organit kompetent komunal.
2. Ndalohet kryerja e punëve ndërtimore ose vendosja e materialit ndërtimor, derdhja e ujit (spërkatja) në rrugë të asfaltuar, trotuar ose sipërfaqe tjera publike përvëç rasteve të caktuara me pëlqim të organit kompetent.
3. Pastrimin dhe larjen e rrugëve mund ta bëj organi kompetent komunal apo operatori ekonomik i cili duhet të ketë parasysh kohën dhe momentin kur më së paku mund të pengoj qarkullimin e lirë të mjeteve dhe këmbësoreve.
4. Orari për pastrimin dhe larjen e rrugëve është nga ora 20:00-24:00, orari mund të ndryshoj me kërkesë të operatorit ekonomik dhe pas aprovimit nga ana e organit kompetent komunal.

**Neni 8**  
**Shenjat mbi emërtimin e rrugëve**

1. Organi kompetent komunal apo operatori i kontraktuar është i obliguar që të gjitha rrugët e Komunës së Gjakovës, të emëroj dhe të pajise me tabelat përkatëse mbi emërtimin e rrugëve dhe ndërroj ato kur kjo është e nevojshme.
2. Ndalohet dëmtimi, heqja apo vendosja e çfarë do reklame apo mbishkrimi në këto tabela.

**Neni 9**  
**Vendosja e tabelave**

1. Organi kompetent komunal apo operatori ekonomik i kontraktuar është i obliguar që të vendos, mirëmbaje tabelat dhe ndërroj ato në raste kur janë të dëmtuara.

2. Vendosja e tabelave në shtylla me emërtime të rrugëve, bulevardeve, shesheve, parqeve etj., duhet të bëhet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.
3. Organi kompetent komunal, është i obliguar të mbajë evidencë mbi rrugët dhe emërtimin e tyre, si dhe kryen me kohë ndërrimin e ndryshimit të evidencave, dhe fillon procedurën për emërtimin e rrugës ose rrugëve të reja dhe udhëheq me procedurën për emërtimin e rrugëve të reja ose riemërtimin e atyre ekzistuese, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.
4. Organi kompetent komunal është i obliguar që brenda 7 ditësh të informoj me shkrim DPI-në për çfarë do ndryshimi, plotësimi, emërtimi të rrugëve.

### **Neni 10** **Vendosja e numrave të objekteve**

1. Organi kompetent komunal është i obliguar të ndërmarrë të gjitha masat me qellim të vendosjes se numrave në shtëpitë private, në çdo ndërtese të banimit kolektiv, ndërtesat e institucioneve, objekteve hoteliere, sportive, bizneseve etj.
2. Pronari i objektit është i obliguar që t'i mirëmbaje numrat e vendosura nga organi kompetent komunal.
3. Numri i shtëpisë apo lokalit duhet të vendoset në vend të dukshëm nga largësia, duhet të vendoset në murin e shtëpisë ose të rrrethojës, në një lartësi optimale, me dimensione, sipas kriterieve të vendosura nga organi kompetent komunal.
4. Të gjithë numrat duhet të kenë gjerësi të njëjtë prej 15 cm x gjatësia e nevojshme varësisht nga numri i shifrave, kurse tabela e njësive brenda objektit shumë banesor ka gjerësi 5 cm x gjatësia e nevojshme.

### **Neni 11** **Trotuaret**

1. Ndalohet vendosja në trotuar dhe në sipërfaqe tjera publike e produkteve të ndryshme ushqimore dhe jo ushqimore, objekteve tjera statike ose lëvizëse, larja e automjeteve, tregtime të ndryshme, aktivitetet sportive ose argëtuese, kërkimin e lëmoshës, vendosja e dheut, gurëve, rërës, zhavorrit, druve, tjegulla, blloka, gëlqere, çimento, armaturë, profile të ndryshme, xhami, ndërtimë të ndryshme, mbeturina të ndryshme, automjeteve të pa përdorshme ose pjesë të tyre, material tjetër për lule ose gjelbërim, mjete tjera për shitjen e ushqimit, tenda lëvizëse ose statike, billborda, ekrane të ndryshme, poster, fletushka reklamuese, gjenerator, vazo, reklama, karrige, manikine (kukulla), tavolina, çadra, guaska ose zbukurime të tjera nga materiali ndërtimor i të gjitha llojeve, ambalazhe dhe paketime të tjera, ose çfarë do materiali tjetër statik ose lëvizës.
2. Për shfrytëzimin e përkohshëm të trotuareve ose hapësirave të tjera publike, aty ku është e mundur një gjë e tillë, vendosë organi kompetent komunal me lëshimin e pëlgimit për shfrytëzim të përkohshëm të hapësirës/lokacionit sipas kriterieve të përcaktuara.

3. Nëse subjektet e pajisura me pëlqim nga organi kompetent komunal nuk respektojnë pëlqimin e lëshuar nga organi kompetent, atëherë organi kompetent komunal mund ta tërheq pëlqimin në çdo kohë.
4. Shfrytëzuesi i trotuarit është i obliguar që dëmet e shkaktuara gjatë shfrytëzimit të trotuarit, ta kthejë në gjendjen e rregullt të mëparshme me shpenzimet e veta.

**Neni 12**  
**Shkarkimi i produkteve në sipërfaqe publike**

1. Shkarkimi i produkteve në trotuar dhe në sipërfaqe tjetra publike mund të bëhet vetëm atëherë kur kjo nuk mund të bëhet brenda ndërtave, hallave, depove ose lokaleve afariste, ose në oborret e tyre, të njëjtat duhet të largohet menjëherë e më së voni në afat prej një ore pas shkarkimit të produkteve.
2. Automjeti i ndalur në skajin e trotuarit ku më së paku pengon, mund të bëjë shkarkimin e produkteve prej automjetit në lokalin afarist sipas orarit të përcaktuar nga organi kompetent.
3. Për shkarkim të produkteve dhe furnizim të lokaleve drejtuesi i automjetit duhet të pajiset me pëlqim për furnizim i cili lëshohet nga organi kompetent, me kërkesë të subjektit.

**Neni 13**  
**Furnizimi i lokalëve afariste me produkte**

1. Orari i furnizimit të lokaleve afariste në kompleksin e Çarshisë së Madhe, është nga ora 07:00-10:00. Përjashtim nga kufizim kohor duhet të kenë furnizimet me material ndërtimor, atëherë kur në këtë kompleks ka lokal apo objekt në ndërtim.
2. Orarin e furnizimit të lokaleve afariste në pjesë tjera të qytetit duhet të bëhet sipas orarit të përcaktuar nga organi kompetent komunal.
3. Organi kompetent është i obliguar që të njoftoj qytetaret, bizneset dhe DPI-në për orarin, se paku 15 dite para vendimit të nxjerre.

**Neni 14**  
**Barrierat**

1. Ndalojen barrierat apo pengesat të ngriturat apo të vendosura në rrugë të asfaltuar apo të pa asfaltuar, të cilat kanë për qëllim ngadalësimin e shpejtësisë të automjeteve.
2. Barrierat mund të vendosen vetëm me pëlqim dhe sipas kritereve të organit kompetent komunal.

**Neni 15**  
**Largimi i borës nga sipërfaqet publike**

1. Largimin e borës dhe akullit, në sipërfaqe publike të komunës së Gjakovës, i kryen operatori ekonomik i cili është i obliguar të veproj në kohë, kështu që të mundësojë qarkullimin e lirë të njerëzve dhe automjeteve.

2. Pastrimin e borës nga trotuaret, para ndërtesave afariste, institucioneve apo shoqatave si dhe grumbullimin e saj në skaj të trotuarit ku pengon më së paku, e kryejnë pronaret ose shfrytëzuesi e lokaleve afariste apo objekteve.
3. Gjatë pastrimit të trotuareve nga pronaret ose shfrytëzuesit e lokaleve, ndalohet hedhja e borës në sipërfaqe të rrugës, bora e pastruar duhet të grumbullohet në trotuar apo cep të rrugës aty ku më së paku e pengon qarkullimin e lirë të automjeteve dhe këmbësorëve.
4. Pastrimin e borës në pjesët e trotuareve ku nuk ka ndërtesa, ose hapësirat e shesheve, vendkalimet në parqe, vendkalimet në ura, vende për të cilat nuk përkujdeset askush, do t'i kryejë operatori ekonomik i cili është i obliguar që borën dhe akullin e grumbulluar në skaje të trotuarit, ta bartin menjëherë në vendet e përcaktuara nga organi kompetent, por jo më vonë se 3 ditë.

### **Neni 16** **Gropimi, rrëmihja, prerja ose shpuarja e sipërfaqeve publike**

1. Gropimi, shpuarja, prerja, rrëmihja në rrugë, trotuar ose sipërfaqe tjeter publike mund të bëhet vetëm me pëlqim paraprakë dhe kriteret e caktuara nga organi kompetent komunal, për vendosjen e instalimeve mbitokësore dhe nëntokësore të rjeteve të reja të kanalizimit, ujësjellësit, nxemjes qendrore, energjisë elektrike, telekomunikimit, për mirëmbajtjen dhe sanimin e tyre si dhe për kyçjen e objekteve ne këto rrjete.
2. Investitori përkatësisht kryesi i punëve pas kryerjes së punëve është i obliguar që ta rregulloj dhe rikthej sipërfaqen publike siç ka qenë më parë.
3. Organi kompetent nuk mund të jap pëlqim për rrëmihje të sipërfaqeve publike në periudhën kohore prej 1 dhjetori deri më 28 shkurt.
4. Rrugët e ndërtuara dhe ri konstruktua rishtazi nuk mund të rrëmihen para periudhës prej 3 (tri) viteve nga përfundimi i ndërtimit apo rikonstruktimit, përvèç në rastet urgjente për nevoja të sanitit të ndonjë infrastrukturë nëntokësore.

### **Neni 17** **Rrethojat dhe streha të ndryshme**

1. Rrethojat, streha, çadrat e ndryshme, objektet tjera lëvizëse ose statike, mund të ndërtohen ose te vendosen në sipërfaqe publike, të ngjiten në muret e lokaleve afariste vetëm në bazë të dispozitave ligjore në fuqi dhe pëlqimit paraprake të organit kompetent komunal.
2. Çdo pronar i rrethojave, strehëve, çadrave të ndryshme, objekteve tjera lëvizëse ose statike të vjetërsuara, të cilat paraqesin pengesa ose e shëmtojnë pamjen e qytetit, është i obliguar që t'i ndërrojë ose t'i mirëmbajë ato në harmoni me kriteret e përcaktuara nga organi kompetent komunal.
3. Është e ndaluar vendosja, ngjyrosja, mbishkrimet ose vizatimi në rrethoja ose objekte të tjera me të cilat nxiten urrejtje të ndryshme, ose prishet estetika e vendbanimit.

**Neni 18**  
**Largimi dhe rrënimi i objekteve**

1. Ndërtesat, muret dhe objektet tjera të cilat nuk mund të shërbejnë për destinimin e vet, ose që japid një pamje jo të mirë apo për arsyen se janë vjetruar, ose paraqesin rrezik për jetën dhe shëndetin e njerëzve, për trafik ose objektet fqinje, duhet patjetër të rrënohen ose të mënjanohen.
2. Vendimi mbi rrënimin, respektivisht mënjanimin e merr Inspektori i Ndërtimit se bashku me Inspektorin e Shërbimeve Publike në Drejtorinë për Punë Inspektuese.
3. Vendimi i inspektorit nxirret pas rekomandimit nga ana e komisionit të emëruar nga Zyrtari Kryesor Administrativ i Komunës.
4. Nëse pronari, respektivisht organi qeverisës ose personi tjetër i autorizuar nuk e rrënon ndërtesën, respektivisht objektin tjetër në afatin e caktuar nga Inspektori, rrënimin do ta bëje operatori ekonomik, gjoba dhe shpenzimet për ketë i vihen pronarit, respektivisht organit qeverisës së objektit.

**Neni 19**  
**Shitjet apo tregtia në sipërfaqe publike**

1. Ndalohet shitja apo tregtia dhe eksposzimi i produkteve jo ushqimore në trotuar, qoshqeve të lokaleve afariste, para lokaleve afariste dhe në sipërfaqe tjera publike.
2. Ndalohet shitja apo tregtia dhe eksposzimi i produkteve ushqimore në trotuar, qoshqeve të lokaleve afariste, para lokaleve afariste dhe në sipërfaqe tjera publike.
3. Shitja apo tregtia dhe eksposzimi i produkteve të përshkruara në paragrafin 1 dhe 2 të këtij nenit mund të kryhen vetëm me pëlqim paraprake të organit kompetent.

**Neni 20**  
**Verandat**

1. Është e ndaluar shfrytëzimi i sipërfaqeve publike për vendosjen e verandave, tendave, çadra të ndryshme dhe objekte tjera statike ose lëvizëse.
2. Vendorsja e verandave, tendave, çadrave dhe objekteve tjera lëvizëse ose statike mund të bëhet vetëm me pëlqim paraprak të organit kompetent.

**Neni 21**  
**Mbishkrimet e firmave dhe reklamat**

1. Pronareve të mbishkrimeve të firmave dhe reklamave (firmave, bizneseve, kompanive, institucioneve, shoqatave etj.,) ju lejohet vendorsja e reklamave apo mbishkrimeve për rastet kur ato kane të bëjnë me zhvillimin e bizneseve të tyre dhe që janë të vendosura në objekt, respektivisht në lokalit afarist, kur këto janë në përputhje me kriteret e vendosura nga organi kompetent komunal.

2. Të gjitha subjektet që merren me biznes, janë të obliguara që të vendosin firmën sipas kritereve të organit kompetent, e cila duhet të vendoset në pjesën e jashtme të hyrjes kryesore të lokalit, në të cilën veprojnë dhe punojnë.
3. Pronarët e firmave dhe shfrytëzuesit e hapësirave punuese janë të detyruar që mbishkrimet e firmave ndriçuese t'i mbajnë në gjendje të rregullt.
4. Ndalohet vodosja e çfarë do reklame e cila është e ndaluar me dispozita të veçanta (siç mund të jene reklamat për produkte të duhanit, etj.).

### **Neni 22 Reklamat në pronën publike dhe private**

1. Është e ndaluar vodosja e çfarë do reklame apo pano reklamuese në pronat private të cilat duken nga jashtë dhe kufizohen me rrugët, si dhe në pronat publike, pa pëlqim të organit kompetent komunal.
2. Organi kompetent komunal me rastin e dhënies së pëlqimit do të përcaktojë kriteret e nevojshme për vodosjen e të gjitha llojeve të reklamave apo panove reklamuese.
3. Pas kalimit të afatit të përcaktuar nga organi kompetent komunal poseduesi i pëlqimit për vodosjen e reklamave, panove, mbishkrimi në hapësira private dhe publike është i obliguar që ti largoje ato ose të kërkoj nga organi kompetent vazhdimin e pëlqimit, në të kundërtën Inspektori mund ta bëj largimin dhe sekuestrimin e tyre.
4. Shpenzimet për largimin e tyre dhe gjoba do ti vihen poseduesit apo ish shfrytëzuesit të pëlqimit.

### **Neni 23 Vitrinat në lokalet afariste**

1. Të gjithë shfrytëzuesit e lokaleve afariste duhet ti shfrytëzojnë vitrinat në përputhje me destinimit të tyre dhe ti mirëmbajnë ato gjithmonë në gjendje të rregullt dhe të pastër.
2. Në rastet e kryerjes së punimeve: renovimit, adaptimit, regjistrimit, ndërrimit të mallrave reklamuese ose braktisjes së objektit afarist, në vitrina duhet të mbyllët pamja për kalimtarët, nga ana e brendshme e vitrinave.
3. Nuk mund të vendosen në vitrina ose të reklamohen produktej, objekte, ose reklama të ndryshme, të cilat janë në kundërshtim me moralin, kulturën, vlerat njerëzore, kombëtare, fetare, racore ose produkte, të cilat për nga pamja e tyre mund të nxisin urrejtje të natyrave të ndryshme si dhe reklama, të cilat për nga pamja e tyre e shëmtojnë pamjen e rrëthit, apo që janë në kundërshtim me kriteret e vendosura nga organi kompetent.

**Neni 24**  
**Tabelat e shpalljeve, lajmërimeve dhe njoftimeve**

1. Ndalohet vendosja e shpalljeve, tabelave tjera reklamuese, njoftuese, vitrina të ndryshme dhe lajmërimet e organizatave politiko-shoqërore, kulturore dhe sportive, konkurset dhe lajmërimë të ndryshme pa pëlqim të organit kompetent komunal, dhe se nuk mund të përdoren për qëllime tjera, përvèç atij të paraparë me pëlqimin.
2. Organi kompetent komunal është i obliguar të caktojë lokacione për vendosjen e një numri të caktuar të tabelave, shpalljeve, lajmërimeve dhe njoftimeve të përshkruara në paragrafin 1 te këtij neni.
3. Është e ndaluar vendosja e të gjitha llojeve të shpalljeve, njoftimeve, lajmërimeve, pllakateve, posterave, mbishkrimeve të ndryshme nëpër mure të ndërtesave të përbashkëta, shtylla, shenjat e trafikut, tabelat e emërtimeve të rrugëve, shtyllave të ndriçimit publik, fasada e objekteve në bashkëpronësi, objekte elektrike, dhe objekteve tjera komunale.

**Neni 25**  
**Shpalljet/njoftimet mortore dhe të ngjashme**

1. Ndalohet vendosja e njoftimeve mortore dhe të tjera në shtylla, pemë dhe ne vende tjera jo adekuate.
2. Organi kompetent është i obliguar që të siguroj dhe përcaktoj vendet adekuate për vendosjen e shpalljeve/njoftime mortore dhe të ngjashme, dhe për te njëjtën të informoj qytetaret dhe DPI-në.

**Neni 26**  
**Ndërtesat dhe pamja e jashtme e ndërtesave**

1. Pronaret e njësive individuale të ndërtesës se banimit në bashkëpronësi, shfrytëzuesit e tyre dhe të lokaleve afariste janë të obliguar që personalisht ose me anë të ndërmarrjes së autorizuar për kryerjen e punëve të caktuara të mirëmbajnë pastërtinë dhe higjenën, të ndërmarrin masa lidhur me pastrimin dhe mënjanimin e çfarëdo dëmtimi në linjën e ujësjellësit dhe kanalizimit brenda në ndërtese, si dhe pastrimin e hapësirave së bodrumeve nëse shkaktohet derdhja e ujërave fekale dhe të ngjashme.
2. Nëse për shkak të prishjes se kanalizimit derdhen ujërat fekale dhe ujërat fundrinore në ndërtesë, shfrytëzuesit/pronaret e lokaleve apo banesave janë të obliguar që me shpenzimet e veta të mënjanojnë prishjen në rrjetin e kanalizimit apo të ujësjellësit.
3. Për pamjen e jashtme të ndërtesës, pronaret e ndërtesave dhe shfrytëzuesit janë të obliguar që fasadat, ballkonet, tarasat, punimeve prej drurit, ulluqet, tabelat e të ngjashme ti mirëmbajnë, ti ngjyrosin, llakojnë sipas kritereve të vendosura nga organi kompetent komunal ashtu që gjithmonë të janë në gjendje të rregullt dhe ta kenë pamjen sa me të bukur.
4. Ju ndalohet pronareve të njësive individuale në bashkëpronësi, shfrytëzueseve të tyre, pronareve apo shfrytëzuesve të lokaleve afariste që të hapin çfarë do vrime me qëllim të

vendosjes se çfarëdo sistemi të ventilimit, gypi në dritare, dyer, vitrina të lokaleve afariste e që përmes tyre të bëhet shkarkimi i mbetjeve/gazrave nga stufa që mund të vijnë si rezultat i djegieve të ndryshme siç mund të jenë drunjtë, qomyri, peleti, naftës dhe të ngjashme. Një gjë e tillë mund të bëhet vetëm përmes sistemit adekuat (oxhaqeve), sipas pëlqimit dhe kritereve të organit kompetent.

### Neni 27

#### **Ndryshimi i pamjes së jashtme të ndërtesave**

1. Pronaret e ndërtesave apo shfrytëzuesit e tyre mund ta ndryshojnë pamjen e jashtme të ndërtesës vetëm sipas kritereve të organit kompetent komunal.
2. Ndalohet që nga ndërtesat të bëhet çfarëdo lëshimi i ujit dhe lëngjeve tjera në sipërfaqet publike.
3. Ndalohet që në mure të jashtme të ndërtesave, në kulme, ballkone etj., të vendoset çfarë do objekti (antena të ndryshme, reklama, pano, tv., etj.,) pa pëlqim të organit kompetent.

### Neni 28

#### **Pastërtia në ndërtesat e banimit në bashkëpronësi**

1. Mbi pastërtinë dhe rregullimin e objektit janë të obliguar të kujdesen pronarët apo shfrytëzuesit e banesave në pajtim me rendin shtëpiak, dispozitave ligjore për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi.
2. Për pastrimin e oborreve dhe ndërtesave banesore e punuese në pronësinë shoqërore, kujdesen personat juridik të cilët i shfrytëzojnë ndërtesat punuese, ndërsa mbi pastrimin e oborreve rrëth ndërtesave banesore dhe hapësirave punuese në pronësi private, kujdesen pronaret.
3. Ndalohet hedhja e mbeturinave të imëta e të mëdha, dhe e pluhurit në hapësirat e përbashkëta, në korridore e bodrume si dhe hedhja e gjësendeve nga dritaret apo ballkonet me të cilët bëhet ndotja e mjedisit.
4. Masat preventive dhe dispozitat ndëshkuese për hedhjen e mbeturinave e qe nuk janë parapare me këtë rregullore janë të përcaktuara me ligje dhe aktet tjera nën ligjore.

### Neni 29

#### **Mirëmbajtja e pastërtisë në hapësira publike**

1. Për mbajtjen e pastërtisë dhe higjenës komunale, në zonë të urbanizuar: sheshe, trotuare, rrugë, parqe, tregje, parkingje, stacione të autobusëve dhe takside, etj. kujdeset organi kompetent apo operatori ekonomik i kontraktuar për mirëmbajtjen e pastërtisë.
2. Në përkujdesje të rregullt dhe me qëllimin e mirë për mirëmbajtjen e pastërtisë dhe të higjenës publike, para lokaleve afariste përkujdesen pronarët, përkatesisht shfrytëzuesit e atyre hapësirave ose objekteve.

3. Organi kompetent apo operatori ekonomik i kontraktuar është i obliguar që se paku 2 here në vit të bëj dezinfektimin, deratizimin dhe dezinfektim në sipërfaqet publike të Komunës së Gjakovës, ndërsa pronaret e ndërtesave në bashkëpronësi apo shfrytëzuesit e tyre janë të obliguar që këta ta bëjnë me shpenzimet e veta.
4. Mbeturinat hedhën vetëm në mjetet (vendet) e destinuara për hedhjen e mbeturinave, ose në deponinë e licencuar dhe të autorizuar për grumbullimin e mbeturinave.

### **Neni 30** **Bartja, deponimi dhe trajtimi i mbeturinave**

1. Për menaxhimin me mbeturina në komunën e Gjakovës përkujdeset operatori ekonomik të cilil i është besuar apo është e kontraktuar për kryejnë e këtyre punëve.
2. Mbeturinat joorganike siç mund të jenë: metali, betoni, plastika, kauçuku, goma, druri, xhami, foli, letra, kartoni, mbeturinat tjera te forta, etj., mund të transportohen nga vetë qytetarët dhe operatoret e licencuar/autorizuar vetëm në vendet ose qendrat e licencuara për grumbullimin, ose përpunimin e tyre.
3. Largimi i mbeturinave, fekaleve dhe ujërave të zeza nga nyja sanitare si dhe pastrimi i gropave septike, mund të bëhet vetëm me mjete të destinuara dhe pajisura për këtë qëllim në mënyre që të mos shkaktohet shpërndarja e mbeturinave si dhe derdhja e fekaleve dhe ujërave të ndotura në sipërfaqet publike ose rrugë.

### **Neni 31** **Largimi i mbeturinave nga sipërfaqet publike**

1. Pastrimi, largimi, transporti dhe deponimi i mbeturinave, nga sipërfaqet publike kryhet nga organi kompetent apo operatori ekonomik i cili ka për obligim, që sipas planit dhe orarit të miratuar nga organi kompetent të zbraze, pastroj dhe dezinfektoi pas çdo zbraze mjetet e mbeturinave: kontejnerët, kovat, enët e madhësive të ndryshme ose mjetet të tjera për grumbullimin e mbeturinave, si dhe të behet pastrimi i mbeturinave për rrith kontejnerëve dhe shtëpizës së kontejnerëve.
2. Operatori ekonomik ka për detyrë që mbeturinat t'i lagojë, më së paku një herë në javë nëpër fshatra dhe në lagjet periferike të qytetit, ndërsa nëpër qendër të qytetit (zonën e pare), mbeturinat në shportat e rrugëve, parqeve, lokaleve afariste, shtëpive të banimit të zbrazen/pastrohen për çdo ditë.
3. Numri i kontejnerëve dhe zbraza e tyre duhet të behet në përputhshmëri me kërkesat e banoreve dhe subjekteve afariste. Operatori ekonomik është i obliguar që të mirëmbajë kontejnerët.
4. Operatori ekonomik i cili menaxhon me terrenet sportive dhe argëtuese, ose hapësira të tjera publike për rekreacion, kanë për detyrë të përkujdesën për pastërtinë dhe higjienën e terreneve dhe objekteve si dhe për rregullsinë e pajisjeve në to.

**Neni 32**  
**Largimi i mbeturinave nga shtëpitë dhe lokalet afariste**

1. Mbeturinat shtëpiake duhet të grumbullohen nga banorët apo shfrytëzuesit e lokaleve në enët e caktuara për mbeturina (kontejnerë, kova, enët e ndryshme, thasë ose qese të ndryshme), të cilat duhet të kenë kapakët e tyre, ose thasë të lidhur dhe vendosen në vendet e mbrojtura dhe të përshtatshme për bartje, jashtë sipërsaqeve (objekteve) dhe që nuk pengohet qarkullimi i lirë mjeteve dhe këmbësoreve.
2. Banoret e shtëpive, banesave ose shfrytëzuesit e lokaleve afariste duhet që mbeturinat ti vendosin para objektit të tyre jo me shumë se një ore përpara kohës kur ato do të mblidhen.

**Neni 33**  
**Obligimet e operatorit ekonomik**

1. Operatori ekonomik është i obliguar që të lidhin kontrate (marrëveshje) me gjithë konsumatorët qe ju kryejnë shërbimin dhe të organizojë të gjithë sistemin për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave, në të gjithë territorin e komunës së Gjakovës, për të cilën gëzon të drejtën për grumbullimin e tarifave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.
2. Operatori ekonomik ka për detyrë që Drejtorisë për Punë Inspektuese t'i paraqesin orarin për grumbullimin e mbeturinave dhe planin e largimit të tyre për muajin e ardhshëm, më së largu deri më datën 15 të muajit.
3. Orari për largim të mbeturinave vendoset në koordinimin dhe pëlqim me organin kompetent të komunës, në mënyrë që mos të pengohet komunikacioni dhe qarkullimi i lirshëm i qytetarëve.
4. Operatori ekonomik është i obliguar që të organizojë dhe furnizojë ekonomitë familjare, bizneset, institucionet, shoqatat dhe bashkësitë tjera me kontejnerë ose mjete të tjera, ose të organizojë formë të tjera të grumbullimit të mbeturinave, dhe të njoftojë me shkrim qytetarët dhe Drejtorinë për Punë Inspektuese për planin operativ të menaxhimit te mbeturinave.

**Neni 34**  
**Obligimet e veçanta të operatorit ekonomik**

1. Inspektorët sipas vlerësimit dhe gjendjes faktike mundet të kërkoj nga operatori ekonomik që në rastet e jashtëzakonshme dhe për shkaqe të tjera të arsyeshme të kërkoj që në pjesët e caktuara të komunës, mbeturinat të largohen menjëherë.
2. Operatori ekonomik është i obliguar që të veproj sipas kërkesës së inspektorit dhe qe është në interes të përgjithshëm.

**Neni 35**  
**Përcjellja e ujërave atmosferike**

1. Uji sipërfaqësor i lumenjve dhe i përroskave duhet të lëvizë në shtratin dhe pjerrtësinë e tyre natyrore dhe se ndryshimi i rrjedhës së ujit sipërfaqësor mund të bëhet vetëm duke arritur

mirëkuptim me të gjithë personat e involvuar në mënyrë direkte me ndryshimin e rrjedhës së ujit sipërfaqësor dhe me pëlqim paraprak të organit kompetent.

2. Uji sipërfaqësor i kanaleve të rrugëve nuk guxon të pengohet në lëvizjen e tij natyrore dhe në këtë kuptim, kanalet e rrugëve duhet të jenë të hapura duke u bazuar në sasinë e mundshme të lëvizjes së ujit sipërfaqësor dhe konfiguracionit të tokës.
3. Në çdo vendkalim nga rruga në pronat e paluajtshme, qytetari duhet të bëjë të mundur qarkullimin e lirë të ujit sipërfaqësor duke ndërtuar ura, lëshesa ose vendosur gypa, ndërkaq në qendrat e urbanizuara duhet të ekzistojë dhe funksionojë kanalizimi atmosferik i cili përbëhet nga rrjeti, pusetat dhe ujëmbledhësit.
4. Urat ose gypat duhet t'i vendosë pronari ose shfrytëzuesi i pasurisë së paluajtshme sipas kritereve të përcaktuara nga organi kompetent, edhe atë në përputhje të plotë me sasinë e mundshme të qarkullimit të ujit sipërfaqësor edhe në rastet e të reshurave atmosferike.

### **Neni 36** **Mirëmbajtja e kanalizimit atmosferik**

1. Pronari ose shfrytëzuesi i objektit është i obliguar për mirëmbajtjen e kanalizimit ose renovimin e kanalizimit brenda banimit. Në raste kur nga dëmtimi i tyre shkaktohen derdhje apo dëme të tjera në sipërfaqe publike apo objekte komunale, pronari apo shfrytëzuesi është i obliguar që menjëherë të veproj.
2. Mirëmbajtjen e kanalizimit, ose renovimin e kanalizimit jashtë objektit të banimit i bartë operatori ekonomik apo organi kompetent i cili është i obliguar që brenda 24 orëve të intervenoj në sanimin e prishjes/bllokimit eventuale.
3. Është i ndaluar dëmtimi, ndërtimi ose vendosja e çfarëdo objekti mbi rrjetin dhe mbi pusetat e kanalizimit atmosferik dhe ujëmbledhësve të kanalizimit atmosferik. Inspektori sipas vlerësimit dhe gjendjes faktike mundet të kërkoj nga operatori ekonomik apo organi kompetent që në rastet e jashtëzakonshme që menjëherë të intervenohet në sanimin e prishjes/bllokimit.
4. Operatori ekonomik apo organi kompetent komunal është i obliguar që përfunksionimin normal të kanalizimit atmosferik, aty ku është i ndërtuar në mënyrë të rregullt ti pastroje pusetat e posaçërisht ujëmbledhësit së paku 2 here në vit.

### **Neni 37** **Përcjellja, trajtimi dhe pastrimi i ujërave të zeza-kanalizimi fekal**

1. Me sistemet e kanalizimit fekal në komunën e Gjakovës, menaxhon operatori ekonomik i autorizuar/kontraktuar apo të cilit i është besuar kryerja e punëve nga organet kompetente me dispozita të vecanta, dhe se i njëjtë është i obliguar që ti mirëmbajë ato.
2. Sipas kërkesës së tij, secili qytetar, pa dallim, ka të drejtë dhe duhet ti krijohet mundësia nga operatori ekonomik që të kyçet në rrjetin e kanalizimit publik fekale duke i plotësuar paraprakisht kushtet teknike për t'u kyçur.

3. Për tu kyçur në rrjetin e kanalizimit, nevojitet pëlqim të cilën e lëshon operatori të cilit i është besuar kryerja e punëve dhe menaxhimi me rrjetin e kanalizimit fekal, ndërsa pëlqimin për rrëmihje të sipërfaqes publike (rrugëve, trotuareve etj.), e jep organi kompetent komunal.
4. Kanalizimin shtëpiak apo të lokaleve afariste që fillon nga kyçja në puset të kanalizimit publik deri në hyrje ë objektit është i obliguar ta mbikëqyrë dhe mirëmbajë operatori ekonomik.

**Neni 38**  
**Mbikëqyrja e kanalizimit fekal**

1. Është i ndaluar ndërtimi ose vendosja e çfarëdo objekti mbi rrjetin dhe mbi pusetat e kanalizimit fekal si dhe rrjetin, pusetat dhe ujëmbledhësve të kanalizimit atmosferik.
2. Secili sistem i kanalizimit fekal, i cili është i ndarë fizikisht, duhet të ketë impiantin për pastrimin e ujërave fekal.
3. Është e ndaluar që ujërat fekal të zbrazen, derdhen, lëshohen, ose kullohen në sipërfaqe publike, oborret fjinje, lumenj, liqeje, përroska, kanale të ndryshme ose në rrjetin e kanalizimit atmosferik, pa u trajtuar.
4. Operatori ekonomik, të cilës i është besuar kryerja e punëve të menaxhimit me sistemet e kanalizimit, gjzon të drejtën për caktimin dhe grumbullimin e taksave për kyçje në kanalizim dhe shfrytëzimin e kanalizimit nga qytetarët në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

**Neni 39**  
**Mirëmbajtja e kanalizimit fekal**

1. Pronari ose shfrytëzuesi i objektit është i obliguar për mirëmbajtjen e kanalizimit ose renovimin e kanalizimit fekale brenda banimit. Në raste kur nga dëmtimi i tyre shkaktohen derdhje apo dëme të tjera në sipërfaqe publike apo objekte komunale, pronari apo shfrytëzuesi është i obliguar që menjëherë të veproj në mënjanim/eliminim të dëmtimit
2. Mirëmbajtjen e kanalizimit, ose renovimin e kanalizimit jashtë objektit të banimit është i obliguar ta bën operatori ekonomik, i cili është i obliguar që menjëherë e me se voni brenda 24 orëve të intervenoj në sanimin e prishjes/blllokimit eventual.
3. Nuk lejohet rrëmihja e sipërfaqeve publike me qëllim të kyçjes në rrjetin e kanalizimeve apo ujit pa pasur pëlqim paraprak nga organi kompetent komunal.
4. Në raste kur behet rrëmihja e sipërfaqeve publike me qellim të kyçjes dhe instalimit në rrjetat e kanalizimeve, investitori, përkatësisht punë kryesi është i obliguar që sipërfaqe e dëmtuar ta kthej në gjendje të rregullt të me parshme.

**Neni 40**  
**Kushtet minimale për pastërti në fshatra**

1. Të gjithë qytetarët, pronarët e ndërtesave familjare të banimit, si dhe pronarët e lokaleve afariste në fshatra, kanë për detyrë të mbajnë pastërtinë përreth objekteve të tyre.
2. Në raste kur nuk ekziston infrastruktura e kanalizimit, obligohen pronarët e lokaleve banesore dhe afariste të kenë të ndërtuar nyjen sanitare sipas dispozitave higjeno-sanitare, larg nga objektet apo burimit e ujit (10m larg objekteve të ujit-puseve) dhe 20m nga objektet banesore të afërtë dhe rruga, varësisht nga konfiguracioni i terrenit.
3. Është e ndaluar vendosja e ushqimit të kafshëve, druve, gurëve, zhavorrit, materialit ndërtimor, etj., përreth rrugës dhe hapësira të tjera publike.

**Neni 41**  
**Nyjet sanitare publike**

1. Nyjet sanitare publike janë të ndërtuara veçmas ose në objektet të destinuara përfreshkim me ujë, si dhe kryerjen e nevojave fiziologjike, ndërkaq, keqpërdorimi, dëmtimi ose përdorimi për nevoja të tjera nuk është i lejuar.
2. Organi kompetent komunal është i obliguar qe të ndërtoj nyjet sanitare publike të cilat duhet të ndërtohen në përputhje të plotë me kushtet teknike dhe ato higjeniko-sanitare.
3. Pastrimin dhe dezinfektimin e kohëpaskohshëm (minimumi 2 here në javë), të nyejve sanitare publike është i domosdoshëm, të njëjtën e kryen shfrytëzuesi i objektit apo hapësirës ku gjendet nyja sanitare apo operatori ekonomik të cilit i është besuar mirëmbajtja.

**Neni 42**  
**Gropat septike**

1. Organi kompetent komunal është i obliguar që të ndërtojë rrjetin e kanalizimit fekal në të gjitha vendbanimet e sidomos në zonën urbane të qytetit. Në rastet kur nuk mund të bëhet kyçja në kanalizim për shkak të konfiguracionit të terrenit apo të mos ekzistimit të rrjetit të kanalizimit fekal publik në ndonjë zonë, qytetarët janë të obliguar ti ndërtojnë gropat septike për derdhje dhe grumbullim të ujërave të zeza dhe atyre fundrinore.
2. Në raste kur ndërtohen/hapen gropat septike që nevojiten për derdhjen, përkatësisht grumbullimin e ujërave të zeza dhe fekaleve të ekonomive familjare, institucioneve, bizneseve ose grupeve të ndryshme të banuesve të përbashkët duhet të pajisjen me pëlgim sipas kriterieve të cilat i përcakton organi kompetent komunal.
3. Gropat septike mund të ndërtohen në vende ku nuk është i shtrire rrjeti i kanalizimit, në lokacione ku nuk ndikohet ose ndikohet më pak në objektet apo burimit e ujit (10m larg objekteve të ujit-puseve) dhe 20m nga objektet banesore të afërtë dhe rruga, varësisht nga konfiguracioni i terrenit. Është e ndaluar të ndërtohen gropat septike në rrugë, trotuare dhe sipërfaqe tjera publike.

- Në qendrat, ku banimi është i dendur dhe mungon rrjeti i kanalizimit, gropat septike duhet të gjenden jashtë ndërtesave, dhe duhet të jenë të larguara nga muri i jashtëm i ndërtesës dhe të ndërtesës së fqiut, më së paku 2m, nëse nuk ekziston asnjë mundësi tjetër për tu larguar më tutje.

#### **Neni 43** **Mirëmbajtja e gropave septike**

- Gropat septike duhet të pastrohen se paku dy herë në muaj, nëse një gjë e tille nuk është nevojshme me shpesh.
- Për mirëmbajtjen dhe pastrimin e gropave septike të nyjave sanitare publike e kryen operatori ekonomik që ka për detyrë mirëmbajtjen e kanalizimit ndërsa për mirëmbajtjen dhe pastrimin e gropave ne hapësira private me interes të përbashkët, kujdesen ndërmarrjet, organizatat, institucionet, këshillat shtëpiake, përkatësisht pronarët e ndërtesave e personat tjerë fizikë dhe juridikë, të cilëve u shërbejnë këto.
- Inspektorati mund te urdhëroj largimin/mbylljen e gropës septike apo nyjës sanitare fushore, në rast se e njëjta nuk është e ndërtuar sipas rregullores, normativave dhe dispozitave ligjore ne fuqi dhe si e tille paraqet rrezik permanent për rrethinën në aspektin shëndetësor-sanitar.

#### **Neni 44** **Gjelbërimi**

- Me qëllim të ruajtjes, zgjerimit, mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbëruara, mbjelljes së drunjtëve të ri në sipërfaqet publike të komunës së Gjakovës, me këtë rregullore vihen nën mbrojtje të caktuar këto sipërfaqe të gjelbëruara: sipërfaqet publike të gjelbëruara, në qendër të qytetit dhe fshatra, parqet, sheshet, kthesat, drunjte rrith rrugës, parkingjet, gjelbërimi në lagjet e banesave, pjesa qendrore e qytetit, para lagjet, zonat e mbrojtura dhe zonat industriale, sipërfaqet e gjelbëruara përreth objekteve të institacioneve, kompanive, shoqatave, ndërmarrjeve publike, bizneseve, dhe subjekteve të tjera, sipërfaqet e ashtuquajtura me destinime të veçanta dhe të dobishme, gjelbërimi rrith dhe në varreza, objekteve përkujtimore, objekteve kulturore dhe historike, si dhe të objekteve të tjera me rëndësi, sipërfaqet e gjelbëruara për sport dhe rekreacion, oborret shkollore, terrenet sportive, vendet për shëtitje dhe rekreacion, lokacionet për vikend dhe kamping, sipërfaqet përreth objekteve hoteliere, motele, bujti, dhe pushimore të ndryshme, sipërfaqet përreth rrugëve, lokale dhe rajonale, lumenjve, përroskave, kanaleve, burimeve të ujit (puset) sipas zonave mbrojtëse të tyre, rezervuarët, si dhe rrith objekteve të tjera përcjellëse, etj.
- Ndalohet dëmtimi i cilës do prej sipërfaqeve të përshkruara në paragrafin paraprak.
- Për pyjet kodrinat e zhveshura, djerrinat, tokat bujqësore dhe pjesë të tjera të te cilat janë të rregulluara me dispozita tjera ligjore, atëherë aplikohen ato dispozita.

#### **Neni 45** **Mirëmbajtja e sipërfaqeve të gjelbërtë**

- Punët e gjelbërimit si mbjelljes, shortimit, prerjes, krasitjes, spërkatjes, mbështjelljes, rrithimit dhe mbrojtjes të sipërfaqeve të gjelbëruara i kryen operatori ekonomik të cilit i besohen këto punë nga organi kompetent komunal.

2. Të gjitha planet-skicat e gjelbërimit duhet të janë të harmonizuara me planin e përgjithshëm të gjelbërimit të qytetit, respektivisht me konceptin e planit urbanistik për të cilin duhet të kujdeset organi kompetent komunal.
3. Para se të bëhet gjelbërimi i sipërfaqeve, shfrytëzuesit e tokës janë të obliguar që të marrin pëlqim për gjelbërim nga organi kompetent komunal.
4. Të gjitha institucionet publike dhe pronaret e tokave/oborreve private janë të obliguar që ti mirëmbajnë (prej, krasit, spërkat) hapësirat gjelbëruese, veçanërisht në raste kur nga ato hapësira mund të vije të ndonjë rrezik potencial për qytetaret.

#### **Neni 46** **Shfrytëzimi dhe rregullimi i sipërfaqeve të gjelbërtë publike**

1. Shfrytëzuesi është i obliguar që të punojë në bazë të kushteve të parapara me pëlqim dhe për çdo ndryshim, i cili nuk është i paraparë në pëlqim, duhet kërkohet pëlqim nga organi kompetent komunal.
2. Gjelbërimi i sipërfaqeve të ndërtimeve të reja duhet të parashihet me projekt mbi ndërtimin dhe rregullimin e sipërfaqeve, në harmoni me planin urbanistik, duke e përcjellë dhe duke ushtruar kontroll profesional të organit kompetent komunal.
3. Sipërfaqet e gjelbëruara në mënyrë jo të rregullt subjekti do t'i shndërrojë në gjelbërim të sipërfaqeve sipas kriterieve te organit kompetent komunal në afat prej gjashtë muajsh nga dita e pranimit të shkresës zyrtare nga Inspektori.
4. Në qoftë subjekti nuk e kryen gjelbërimin në afatin e caktuar nga Inspektori, këtë do ta bez operatori ekonomik, shpenzimet dhe gjoba do ti vihen pronarit apo shfrytëzuesit të tokës.

#### **Neni 47** **Ndalesat në sipërfaqet e gjelbërtë publike dhe parqe**

1. Ndalohet prerja, thyerja, nxjerra, dëmtimi, i drunjëve, gjelbërimi ulët, kositja me qëllim përvetësimi, shkelja dhe dëmtimi i çfarëdo lloji të barit, bimëve dhe luleve të ndryshme, ngasja ose parkimi i automjeteve në sipërfaqet e gjelbëruara, shkarkimi ose deponimi i çfarëdo materiali ndërtimor ose tjetër, dëmtimi, largimi, djegia e ulëseve të ndryshme, shportave ose kontejnerëve, rekuizitave, reklamave, tabelave, shenjave, hidrantëve, aleve për këmbësorë, rrethojave si dhe instalimeve të tjera të ndryshme, shfrytëzimi i sipërfaqeve publike dhe të tjera të gjelbëruara jashtë destinimit të tyre themelor ose kryerja e çfarëdo veprimtarie në to ose derdhja e çfarëdo materiali ose lende, nëpër sipërfaqe të gjelbërtë, drunj dhe pjesë të tjera të tyre, lëvizja (ecja) ose vrapimi jashtë stazës të shënuara për këmbësorë, qëndrimi, ulja ose shtrirja në sipërfaqeve të gjelbëruara, lëshimi, derdhja e ujërave të zeza, ujërave fundrinore, fekaleve, dhe lëngjeve të ndryshme në sipërfaqet e gjelbëruara publike, keqpërdorimi i ujërave në fontana ose kroje publike, gjuetia e shtazëve ose shpezëve në këto zona, vendosja e lojërave, luhajave, cirkut, manifestimeve ose tubimeve të tjera, shfrytëzimi i hapësirave të gjelbëruara për kullosa të kafshëve dhe shpezëve shtëpiake, ndezja e zjarreve për qëllime: grilli, pushimi, festimi, ose argëtimi, hedhja e mbeturinave të ndryshme, rrëmihja ose gropimi i sipërfaqes së gjelbëruar, veprimet tjera të cilat janë në dëm të sipërfaqeve të gjelbëruara.

2. Ne raste të caktuara dhe për qëllime të mira, përmirësimit, mirëmbajtjes e të ngjashme, veprimet e përshkruara në paragafin 1 të këtij neni mund të lejohen vetëm me pëlqim paraprak të organit kompetent komunal.

#### **Neni 48**

#### **Vendosja e instalimeve në sipërfaqe të gjelbërta publike**

1. Vendosja e instalimeve nëntokësore në sipërfaqet e gjelbëruara, bëhet në distancë sa më të largët të mundshme nga fidanja e mbjella, në përputhje me praktikat e mira.
2. Rrëmihja apo gropimi i sipërfaqeve të gjelbërta (në parqe, sheshe, oaza etj.,) me qellim të vendosjes se rrjetave të ujësjellësit, kanalizimeve, shtrirjes se rrjetit elektrik, tele komunikuese, ngrohjes qendrore etj., mund të bëhet vetëm me pëlqim paraprak të organit kompetent komunal.
3. Pas vendosjes se instalimeve, punë kryesi ose investitori është i obliguar që sipërfaqen e dëmtuar ta kthej në gjendje të mëparshme.

#### **Neni 49**

#### **Obligimet e operatorit ekonomik**

1. Operatori ekonomik, të cilit i janë besuar punët e mirëmbajtjes së gjelbërimit, është i obliguar që menjëherë t'i largoje drunjtë ose degët e dëmtuara ose të shkëputura për shkak të ndikimit të kushteve natyrore, atmosferike ose kushteve të tjera të pa parapara, barin e kositor si dhe materialin e mbetur nga puna ta largoje nga sipërfaqet e gjelbëruara publike ku është kryer puna, sipërfaqet e gjelbëruara t'i furnizojet me pleh artificial, natyral, të mihië sipërfaqet e gjelbëruara ku janë mbjellë fidanë të reja, gjelbërim i ulët, lule etj., që të preje ose krasitë degët e rritura të drunjëve, të cilat i pengojnë kabllot elektrike të telefonisë dhe të tjera, që të preje degët të cilat pengojnë dukshmérinë në komunikacion dhe dukshmérinë e shenjave të trafikut, që të preje degët që pengojnë lëvizjen e lirë të automjeteve në rrugë dhe këmbësorëve, në trotuar, që të preje degët, të cilat pengojnë lëvizjen e lirë të ujit në lumenj e përrroska etj.
2. Dëmet e shkaktuara në sipërfaqe të gjelbëruara nga ana e subjekteve apo nga natyra do të vlerësohet nga ana e komisionit, të cilin e emëron organi kompetent komunal.
3. Operatori ekonomik është i obliguar që në vende të dukshme të vendosë pllakatat ose shenjat në të cilat janë të shënuara ndalesat ose vërejtjet në rastet e keqpërdorimit të hapësirave të gjelbëruara publike.
4. Operatori ekonomik të cilit i janë besuar punët e mirëmbajtjes së rregullt të gjelbërimit, është i obliguar që nëpër parqe, qendër, sheshe, rrugë e kthesa të gjelbëruara, të vendosë dhe të mirëmbajë ulëset për pushim, shportave për mbeturina të imta, sipas kritereve të vendosura nga organi kompetent komunal.

**Neni 50**  
**Ndriçimi publik**

1. Për menaxhimin dhe mirëmbajtjen ndriçimit publik të rrugëve, trotuareve dhe parqeve, kujdeset organi kompetent komunal ose operatori ekonomik, të cilat i janë besuar këto punë dhe se i njëjtë është i obliguar që ato ti mirëmbajë.
2. Ndalohet vendosja dhe modifikimi i shtyllave elektrike, llambave dhe komponentëve tjera të ndriçimit publik nga subjekte te pa autorizuar nga organet kompetente.
3. Të gjitha rrugët (kryesore, sekondare), sheshet dhe parqet në të cilat është i vendosur ndriçimi publik duhet të jene të ndriçuara natën me ndriçim optimal.
4. Shtyllat e ndriçimit publik duhet të janë stabile në pozitë vertikale në mënyrë që të mos cenojnë sigurinë e kalimtarëve dhe të pasurisë, shtyllat duhet të janë të mbrojtura nga aspekti i elektricitetit, si dhe te kenë gjithmonë te vendosur kapakun (mbyllësin) e siguresave në gjendje të rregullt për mbrojtje nga lagështia apo çfarë do rreziku tjetër potencial për qytetaret dhe rrethin në përgjithësi.

**Neni 51**  
**Mirëmbajtja e ndriçimit publik**

1. Operatori ekonomik për mirëmbajtjen e ndriçimit publik duhet të kujdeset që shtyllat e dëmtuara të ndriçimit të rregullohen sa më parë e më së largu 3 ditë nga dita e prishjes, që të ndërrojë poçat e thyera, si dhe të bëjë eliminimin e defekteve tjera, ndërsa ngjyrosja gjenerale e të gjitha shtyllave të sistemit të ndriçimit publik duhet të bëhet së paku një herë në 3 vjet.
2. Është e ndaluar dëmtimi i shtyllave të ndriçimit publik, gjërvishtja apo ngjyrosja e tyre, thyerja e poçave dhe mbrojtësve të tyre si dhe manipulimi me siguresat dhe përquesit e vendosur në kudit shpërndarëse të shtyllave. Shfrytëzimi i shtyllave të ndriçimit publik me qëllim të vendosjes së reklamave, shenjave, udhëtregueseve etj., mund të bëhet vetëm me pëlqimin e organit kompetent komunal.
3. Ndalohet shtrirja e rrjetit elektrik, përquesve në afërsi të shtëpive, dritareve, ballkoneve, pullazeve, institucioneve publike dhe private etj., të cilat paraqesin rrezikpër qytetaret dhe të cilat nuk i plotësojnë normativat teknike të parapara për këto rrjete.
4. Inspektori në çdo kohë mund të urdhëroj heqjen e çfarë do objekti nga shtyllat në rastë kur ato janë vendosur pa pëlqim të organit kompetent, apo kur konstaton se rrjeti elektrik apo shtyllat paraqesin rrezik për qytetaret dhe rrethin, menjëherë urdhëron operatorin ekonomik përgjegjës për eliminimin e saj.

**Neni 52**  
**Tregjet**

1. Në tregje të cilat janë vende të hapura ose të mbuluara e që duhet të janë të vendosura në lokacione të caktuara me pëlqim paraprak të organit kompetent komunal mund të kryhet shitblerja e produkteve në ditën e përcaktuar nga organi kompetent komunal.

2. Në tregje mund të kryhen edhe shitblerje për çdo ditë nëse kjo nuk është paraparë ndryshe me ndonjë vendim të organit kompetent ose rregullore tjetër komunale dhe seshitësit janë të obliguar që të paguajnë tarifën për shfrytëzimin e lokacionit të tregut të paraparë sipas marrëveshjes ndërmjet operatorit ekonomik dhe organit kompetent komunal.
3. Në raste të veçanta mund të lejohet nga organi kompetent komunal që shitblerja e produktave të kryhet në vendin (lokacionin) e caktuar, ose shitblerje me mjet lëvizës, me pëlqim paraprak të organit kompetent komunal.
4. Nuk është e lejuar shkarkimi i mallrave, plaçkave, materialit ndërtimor etj., në lokacionet e tregjeve me qëllim që aty të qëndrojnë me shume se dy dite, përveç në rastet kur organi kompetent komunal ka lejuar një gjë të tillë me pëlqim.

**Neni 53**  
**Menaxhimi i tregjeve**

1. Mbikëqyrjen, mirëmbajtjen dhe menaxhimin me tregjet në komunën e Gjakovës e ushtron organi kompetent i komunës se Gjakovës apo operatori ekonomik të cilat i janë besuar punët e menaxhimit, i cili është i obliguar që të veproj sipas kushteve të caktuara nga organi kompetent.
2. Nuk është i lejuar zhvillimi i asnjë lloj aktiviteti tjetër përveç atij të paraparë me marrëveshje/kontratë në mes të organit kompetent komunal dhe operatorit ekonomik.
3. Operatori ekonomik duhet të kujdeset përfundimisht që siguruar kushte sa më të favorshme përfundimisht që kryerjen e afarizmit në ditën e tregut, duke pajisur tregun me elementet higjieno-teknike e sanitare.
4. Operatori ekonomik është i obliguar që të mirëmbaje, pastroj dhe të ndërmerr gjitha masat e nevojshme me qellim të krijimit te kushteve sa më të mira në treg.

**Neni 54**  
**Furnizimi i me ujë-Ujësjellësi**

1. Sistemet e ujësjellësit në komunën e Gjakovës do të menaxhohen nga operatori ekonomik të cilat i janë besuar punët e menaxhimit i cili e ka përfundimisht që të mirëmbajë rrjetin e ujësjellësit bashkë me nyjet përcjellëse deri te ujëmatësi i konsumatorit.
2. Operatori ekonomik duhet të ketë një kopje të projektit final të sistemit të ujësjellësit, si dhe duhet që të përcjellë çdo ndryshim ose shtim të pozicioneve të projektit me anekse shtesë, ky duhet të jetë në gjendje që në çdo moment të ofrojë shënimë përfundimisht teknike dhe të përgjithshme të sistemit të ujësjellësit.
3. Operatori ekonomik e ka përfundimisht që konsumatorëve të ju sigurojë sasi të mjaftueshme të ujit higjenik.
4. Operatori ekonomik dhe konsumatori kanë përfundimisht që parandalojë dhe të pengojë çdo derdhje të pa kontrolluar të ujit ne sipërfaqe publike si dhe keqpërdorimin e ujit të pijes.

**Neni 55**  
**Ndërprerja e furnizimit me ujë**

1. Në qoftë se paraprakisht është planifikuar ndërprerja e furnizimit me ujë, operatori ekonomik apo ndërmarrja ka për detyrë që më së paku 24 orë përpara ta njoftoj konsumatoret permes informimit masiv, me orarin e ndërprerjes. Operatori ekonomik, përkatësisht ndërmarrja është e obliguar që 24 ore përpara ta njoftoj me shkrim edhe Drejtori në për Punë Inspektuese.
2. Në rast të thatësisë dhe pengesave tjera të furnizimit me ujë të piques, operatori ekonomik është i obliguar që të ndërmerrë masat teknike të kufizimit të shpenzimit të ujit.
3. Operatori ekonomik në këto raste do ti propozoje organeve përkatëse të Komunës që me urdhëresë të veçantë të caktoj mënyrën e shpenzimit te ujit për disa konsumator të caktuar.

**Neni 56**  
**Kyçja në rrjetin e ujësjellësit**

1. Pëlqimin për kyçje në rrjetin e ujësjellësit, sipas kërkesës së konsumatorit, e lëshon operatori ekonomik të cili i është besuar menaxhimi, ndërsa pëlqimin për rrëmihjen e rrugëve, trotuareve dhe sipërfaqeve tjera publike me qellim të realizimit të kyçjes në rrjetin e ujësjellësit e lëshon organi kompetent komunal.
2. Çdo konsumator i rrjetit të ujësjellësit duhet të vendosë ujëmatës sipas dispozitave ligjore të veçanta.
3. Tarifat e ujit, ndërrimi i ujëmatësit, të kyçjes së përsëritur etj., përcaktohen nga operatori ekonomik, ne përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.
4. Rregullimin e veprimtarive të ofruesve të shërbimeve të ujësjellësit, ujërave të ndotura, të furnizuesve të ujit me shumicë dhe shërbimet e ujit e që nuk janë përcaktuar me këtë rregullore, rregullohen me ligje të veçanta.

**Neni 57**  
**Furnizimi me energji termike – Ngrohja qendrore**

1. Furnizim të lagjeve me energji termike-ngrohje qendrore nënkuftohet ndërtimi, mirëmbajtja dhe shfrytëzimi i rrjetit magjistral dhe shpërndarës të qytetit në lagje, blloqe dhe objekte të veçanta të kyçura në ngrohje qendrore të qytetit.
2. Pronarët e njësive individuale të ndërtësës së banimit në bashkëpronësi, në pronësi private apo shoqërore, të cilët posedojnë me ngrohje qendrore janë të obliguar të lidhen në rrjetin termik publik në afat prej 1 (një) viti prej ditës së ekzistimit të mundësisë teknike për lidhje.

**Neni 58**  
**Financimi, ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrjetit të ngrohjes**

1. Financimi dhe ndërtimi i rrjetit unik termik të qytetit kryhet nëpërmjet ndërmarrjes që merret me ngrohjen e qytetit (operatorit ekonomik të cilin i janë besuar punët e ngrohjes qendrore) në bazë të planit për zgjerimin e rrjetit në qytet dhe paralagje.

- Ndërmarrja apo operatori ekonomik të cilit i janë besuar punët e ndërtimit, të mirëmbajtjes dhe shfrytëzimit të tërësishëm dhe të stabilimenteve për ngrohjen e qytetit, është i detyruar që tërë sistemin ta mirëmbajë në mënyrë permanente në gjendje të rregullt dhe të shfrytëzueshme, kurse konsumatorëve të energjisë termike ti sigurojë vazhdimisht energjinë e projektuar termike nga sistemi unik termik i qytetit.
- Kompensimi për ngrohje të lokaleve me energji termike nga ngrohja e qytetit, paguhet sipas kriterieve të operatorit ekonomik dhe në pajtim me dispozitat ligjore përkatëse.

**Neni 59**  
**Dërgimi i energjisë ngrohëse dhe sezioni i ngrohjes**

- Ndërmarrja apo operatori ekonomik është i obliguar që të bëjë ngrohjen e objekteve nga 15 tetori deri më 15 prill të vitit të ardhshëm. Përjashtimisht jashtë kësaj periudhe, objektet mund të ngrohen në rast se temperatura e jashtme është më e ulët se  $14^{\circ}\text{C}$  në orën  $13.00$  tri ditë rreshtë.
- Ndërmarrja apo operatori ekonomik është i obliguar që gjatë periudhës së ngrohjes të sigurojë temperaturën e ngrohjes së ujit prej min.  $90^{\circ}\text{C}$  në nënstacionet e objekteve, respektivisht që në banesa dhe lokale të sigurojë temperaturë të nevojshme prej  $22^{\circ}\text{C}$ .

**Neni 60**  
**Kushtet e kyçjes dhe ndalesat**

- Lidhja-kyçja në rrjetin primar të largpërçuesit termik bëhet me pëlqimin dhe kushtet e dhëna nga ndërmarrja apo operatori ekonomik.
- Ndalohet rrëmihje e sipërfaqeve publike me qëllim të kyçjes pa pëlqim paraprak të organizoj kompetent komunal.
- Është i ndaluar dëmtimi i rrjetit primar të ngrohjes qendrore, pusetave, nënstacioneve dhe stabilimenteve të pompave.

**Neni 61**  
**Varrezat, rregullimi dhe mirëmbajtja e tyre**

- Varrezat janë një hapësirë e rrëthuar e tokës, e cila me planin urbanistik përkatës është caktuar për varrimin e të vdekurve, në të cilat gjenden objektet përcjellëse dhe infrastruktura tjeter e nevojshme dhe ajo komunale.
- Operatori ekonomik përkatësisht ndërmarrja është e obliguar që ta bëj rregullimi dhe mirëmbajtja e varrezave, në kuqim të kësaj rregulloreje e cila nënkupton pajisjen e hapësirës për varrim, rregullimin, pajisjen dhe mirëmbajtja e objekteve dhe përbajtjeve tjera në varreza, të cilat shërbejnë për kryerjen e shërbimit të varrimit (krematoriumi, morgu, WC-të publike, krojet publike e të ngjashme), rregullimi dhe mirëmbajtja e rrugëve dhe shtigjeve brenda varrezave dhe hapësirës në mes të varreve, mirëmbajtja e gjelbërimit, ndriçimit publik e pastërtisë dhe e rendit në varreza, largimi i borës dhe akullit brenda varrezave si dhe

punëve tjera që kanë të bëjnë me rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave, varreve dhe simboleve mbi varre.

3. Rregullimi dhe mirëmbajtja e varrezave dhe varrimi është veprimtari komunale e interesit të përgjithshëm dhe për mirëmbajtjen e tyre siç është përshkruar ne paragafin dy të këtij neni është i obliguar operatori ekonomik.
4. Varrezat mund të jenë të përgjithshme (Publike) dhe të veçanta. Varrezat të veçanta konsiderohen varrezat përkujtimore dhe varrezat e bashkësive të caktuara fetare ndërsa varrezat e veçanta mund të rregullohen si pjesë e ndarë e varrezave të përgjithshme.

#### **Neni 62**

#### **Operatorët për varrimin, rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave**

1. Varrimin, rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike , në qytetin e Gjakovës e bënë ndërmarrja publike komunale K.R.M “Çabrati” apo operatori tjetër ekonomik të cilin i janë besuar apo është i kontraktuar nga organit kompetent komunal për kryerjen e këtyre punëve.
2. Rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave në fshat e bënë këshilli i fshatit i cili është i obliguar që të mirëmbajtje varrezave nëse nuk është përcaktuar ndryshe nga organi kompetent komunal.
3. Ushtrimin e veprimtarisë, nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni, Komuna mund t’ia operatorit ekonomik tjetër, përkatësisht ndërmarrjes.
4. Operatorit ekonomik të cilin i janë besuar besohen punët është i obliguar që në punën e saj, në tërsi, t’i përbahet ligjit dhe dispozitave të kësaj rregulloreje.

#### **Neni 63**

#### **Programi për rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave**

1. Rregullimi dhe mirëmbajtja e varrezave bëhet sipas programit vjetor të rregullimit dhe mirëmbajtjes të cilin e nxjerrë ndërmarrja, përkatësisht operatori, deri me 31 Dhjetor të vitit vijues për vitin pasues, me pëlqimin paraprak të organit kompetent komunal.
2. Programi nga paragrafi 1 i këtij neni përmban: llojin, vëllimin dhe dinamikën e punëve si dhe lartësinë e mjeteve të nevojshme për realizimin e tij.
3. Ndërmarrja përkatësisht operatori është i obliguar që Drejtorisë për Punë Inspektuese t’i dërgojë planin e mirëmbajtjes së varrezave sipas muajve për vitin vijues, në afat prej 10 ditësh prej nxjerrjes së programit nga paragrafi 1 i këtij neni.

#### **Neni 64**

#### **Vendosja, riparimi dhe heqja e përmendores, simboleve dhe objekteve tjera**

1. Për vendosjen, riparimin dhe heqjen e përmendores dhe sendeve të tjera në vendvarrim është i nevojshëm pëlqimi i operatorit ekonomik.

2. Në varreza është e ndaluar ngritja dhe vendosja e simboleve, dhe shenjave të tjera, të cilat nuk janë në lidhje me personat e varrosur në varreza.
3. Është e ndaluar vendosja e simboleve, përmendoreve dhe përkujtimoreve në vendvarrime të cilat me dukjen, shenjat apo mbishkrimet, ofendojnë ndjenjat, patriotike, fetare, nacionale dhe ndjenjat tjera të qytetarëve.

**Neni 65**  
**Shërbimet për varrimin e të vdekurve**

1. Ndërmarrja, përkatësisht operatori është e obliguar që të sigurojë çdo ditë të javës shërbimet për varrimin e të vdekurve.
2. Personat të cilët bëjnë varrimin janë të obliguar të mbajnë uniformën përkatëse të cilën e siguron operatori, përkatësisht ndërmarrja.

**Neni 66**  
**Regjistri i personave të vdekur dhe rendi në varreza**

1. Ndërmarrja përkatësisht operatori, është e obliguar të mbajë dhe të ruaj regjistrin e personave të vdekur sipas emrit, mbiemrit, emrit të babait, numrit personal të qytetarëve të personit të vdekur me shënimin se ku është varrosur.
2. Ndërmarrja, përkatësisht operatori është i obliguar të sigurojë mbajtjen e rendit dhe qetësinë në varreza.
3. Varrezat janë të hapura për vizitorë çdo ditë, dhe këtë në periudhën prej 1 prillit deri me 30 shtator prej orës 7:00 deri në orën 19:00, kurse prej 1 Tetorit deri me 31 Mars prej orës 7:00 deri në orën 18:00. Për mos respektim të këtij orari, përgjegjës është operatori ekonomik përkatësisht ndërmarrja.

**Neni 67**  
**Ndalesat në varreza**

1. Në varreza është e ndaluar: hyrja dhe qëndrimi jashtë kohës së përcaktuar për vizitorë, qëndrimi i fëmijëve më të rinj se 10 vjeç pa përcjelljen e personit të rritur, kërcimi i rrëthojës, shkelja e sipërfaqeve të gjelbëruara, thyerja e drunjëve, këputja e luleve dhe të mbjellave tjera, shkelja, përlyerja dhe përdhosja e vendvarrimeve, shkaktimi i dëmeve në përkujtimoret mbi varreza dhe sendet tjera në vendvarrime, prishja e qetësisë në varreza, futja e kafshëve në territorin e varrezave, vozitja e bicikletës, motoçikletës dhe automjetit tjetër nëse kjo nuk është lejuar me pëlqim të veçantë të ndërmarrjes, përkatësisht operatorit, shkaktimi i papastërtisë dhe hedhja e luleve të vyshkura në sipërfaqet e gjelbëruara, rrugë dhe shtigje, lënia e ushqimit në vendvarrime dhe në vende tjera në varreza, fotografimi në formë të profesionit dhe kryerja e shërbimeve tjera pa pëlqimin e ndërmarrjes, përkatësisht operatorit, shitja e çfarëdo lloj produkti pa pëlqimin e ndërmarrjes, përkatësisht operatorit, hyrja në morg jashtë kohës së caktuar për varrim, ndezja e qirinjve në varre jashtë kohës së caktuar për varrim, montimi i objekteve tjera, shtëpizave për qirinj, rrethojave etj., në platon e varrit, përkatësisht në vendvarrimit nëse kjo nuk është e paraparë me projektin për përkujtimore,

mbjellja e drunjëve përreth varreve dhe vendvarrimeve pa pëlqimin e ndërmarrjes, përkatësish operatorit.

2. Ne raste të caktuara dhe për qëllime të mira, përmirësimit, mirëmbajtjes e te ngjashme veprimet e përshkruara në paragafin 1 të këtij neni mund të lejohen vetëm me pëlqim paraprak të organit kompetent komunal.

#### **Neni 68**

#### **Vendosja e dispozitave të rendit në varreza**

1. Ndërmarrja, përkatësish operatori ekonomik është i obliguar që dispozitave të kësaj rregullore ti përbahet në tërsi.
2. Dispozitat e rendi në varreza duhet të vendosën nga operatori ekonomik në vend të dukshëm, në hyrje të varrezave.

#### **Neni 69**

#### **Mjetet për kryerjen e veprimitarisë komunale të varrimit**

1. Mjetet për kryerjen e veprimitarisë komunale të varrimit sigurohen nga kompensimi të cilin e paguajnë shfrytëzuesit e drejtpërdrejte.
2. Mjetet për rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave sigurohen në buxhet nga kompensimi për shfrytëzimin e tokës ndërtimore nga mjetet e ndërmarrjes përkatësish operatorit nga kompensimi për shfrytëzimin e vendvarrimit si dhe nga burime tjera në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse.

#### **Neni 70**

#### **Çmimi i shërbimeve të varrimit**

1. Për varrim dhe shërbimet tjera lidhur me varrmin (transporti i të vdekurit dhe ceremoniali i varrimit etj.,) ndërmarrja, përkatësish operatori përcakton çmimin e shërbimeve, me pëlqimin paraprak të organit kompetent komunal.
2. Çmimi i shërbimeve nga paragrafi 1 i këtij neni, paguhet edhe me rastin e zhvarrosjes së mbetjeve mortore.

#### **Neni 71**

#### **Mbikëqyrja e zbatimit të rregullores**

1. Mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj rregullore e bën Drejtorati për Punë Inspektuese.
2. Inspektoret e Mjedisit, Sanitar, Tregut, Veterinës, Bujqësisë dhe Ndërtimit në kuadër të DPI-së, janë të obliguar që ti asistojnë Inspektoret e Shërbimeve Publike kur një gjë e tille ju kërkohet.

**Neni 72**  
**Inspektimi**

1. Inspektori kryen inspektim sipas detyrës zyrtare dhe në bazë të ankesës së palës së tretë.
2. Inspektori është i detyruar që të informojë parashtruesin e ankesës lidhur me gjendjen e konstatuar, respektivisht masat e ndërmarrë brenda tetë (8) ditësh kalendarik.
3. Inspektori në çdo kohë mund të ndaloj çfarë do veprimi të subjektit apo operatorit ekonomik i cili vepron në kundërshtim me këtë rregullore.
4. Nëse inspektori konstaton parregullsi, mund të lëshoj urdhëresë me shkrim për subjektin që të eliminoj parregullsitë e konstatuara.
5. Afati për eliminimin e parregullsive nuk mund të jetë me i gjatë se pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarik.
6. Subjekti është i detyruar të veproj sipas urdhëresës dhe ta informoj inspektorin se parregullsitë janë eliminuar, brenda afatit të dhënë nga inspektori.
7. Nëse subjekti apo operatori ekonomik/ndërmarrja apo investitori nuk vepron sipas urdhëresës së inspektorit, atëherë inspektori mund të kërkoj që këtë ta bëj operatori tjetër ekonomik, gjoba dhe shpenzimet do ti vihen subjektit të urdhëruar.
8. Subjekti i inspektuar, konsiderohet që nuk i ka mundësuar inspektorit inspektimin, nëse nuk siguron qasje në dokumente të nevojshme për të konstatuar gjendjen faktike.
9. Në rastet kur ekziston rreziku serioz ndaj jetës dhe shëndetit të njerëzve, inspektori mund të jep urdhër me gojë.
10. Inspektori, menjëherë e më së voni brenda dyzetetë (48) orësh do të nxjerr urdhëresë me shkrim me të cilin do të vërtetoj urdhëresën gojore.
11. Nëse inspektori nuk ka autorizim për të inspektuar një çështje specifike në ndonjë fushë të caktuar, në të cilën ka vërejtur parregullsi, ai duhet të informojë me shkrim menjëherë organin tjetër kompetent për veprim.
12. Elementet formalo-juridike që duhet t'i përbaj akti juridik që e lëshon inspektori, janë të përcaktuar në Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

**Neni 73**  
**Sekuestrimi**

1. Nëse inspektori konstaton se subjekti ka vendosur produkte, objekte tjera statike ose lëvizëse në sipërfaqe publike pa pëlqim të organit kompetent mund ti sekuestroj ato.
2. Subjektit të cilit i janë sekuestruar produktet i lëshohet vërtetimi i cili përmban shënimë të sakta mbi produktet e sekuestruar sipas llojit dhe sasisë.

3. Produktet e sekuestruara në baze të kësaj rregullore i kthehen subjektit pas pagesës se gjobës.
4. Produktet ushqimore të cilat sekuestrohen, dërgohen në depon e DPI-së, të njëjtat nëse nuk tërhiqen në afat prej 48 orësh, atëherë Drejtori i DPI-së cakton komision i cili vendos se produktet e sekuestruara, a do të asgjësohen, a do të shiten, ose a do ti dorëzohen organit respektivisht subjektit të interesuar, duke respektuar dispozitat ligjore në fuqi.
5. Produktet jo ushqimore të cilat sekuestrohen, dërgohen në depon e DPI-së, të njëjtat nëse nuk tërhiqen në afat prej 30 ditësh kalendarik, atëherë Drejtori i DPI-së cakton komision i cili vendos se produktet e sekuestruara, a do të asgjësohen, a do të shiten, ose a do ti dorëzohen organit respektivisht subjektit të interesuar, duke respektuar dispozitat ligjore në fuqi.
6. Asgjësimi i produkteve ushqimore të konstatuara si jo të sigurta asgjësohen në baze të vendimit së Inspektorit Sanitar.

**Neni 74**  
**Fillimi i procedurës ndëshkuese**

1. Në rastet kur konstatohet se janë shkelur dispozitat e kësaj rregullore, inspektori është i obliguar që brenda tetë (8) ditësh kalendarik nga dita e konstatimit të shqipton gjobë.
2. Nëse subjekti i gjobitur e bën pagimin e gjobës, në afatin e përcaktuar nga Inspektori, lirohet nga pagimi 50% nga shuma e gjobës së shqiptuar.
3. Në rast se subjekti i gjobitur nuk e paguan gjobën brenda afatit të dhënë, inspektori brenda tridhjete (30) ditësh kalendarik pasi vendimi të behet i plotfuqishëm ka të drejtë të filloj edhe procedura tjera administrative për inkasimin e gjobës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Inspektori kur konstaton se janë shkelur dispozitat e kësaj rregullore, brenda tetë (8) ditësh kalendarik mund të paraqet kërkese për fillim të procedurës për kundërvajtje në gjykatën kompetente, kur kjo është e parapare me ligje të veçanta.
5. Inspektori është i detyruar të informoj organet kompetente nëse konstaton se ekziston dyshimi i bazuar që përmes shkeljes së ligjeve është kryer vepër penale.
6. Vendimi apo urdhëresa përmes të cilit shqiptohet gjoba do të cilësohet dokument përbartues në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

**Neni 75**  
**Procedura ankimore**

1. Kundër vendimit të inspektorit lejohet ankesë brenda afatit prej tetë (8) ditëve kalendarike.
2. Ankesa i drejtohet komisionit për shqyrtimin e ankesave kundër vendimit të Inspektorit.
3. Komisioni prej tre anëtaresh i propozuar nga Drejtori i DPI-se dhe i miratuar nga Zyrtari Kryesor Administrativ i Komunës, është i detyruar që në afat prej tridhjetë (30) ditësh

kalendarik nga dita e paraqitjes se ankesës të vendos për ankesën e ushtruar kundër vendimit të inspektorit.

4. Parashtrimit i ankesës kundër vendimit të inspektorit nuk e ndalon ekzekutimin e tij.
5. Kundër vendimit të komisionit mund të parashtrohet padi në Gjykatën kompetente në afat prej tridhjetë (30) ditësh.

**Neni 76**  
**Gjobat**

1. Personi fizik apo personi përgjegjës i personit juridik gjobitet me gjobë nga njëzet (20) euro, dhe jo me shumë se njëmijë (1.000) euro, nëse: shkel dispozitat e nenit 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, nenit 22 (paragrafi 1, 2 dhe 3), nenit 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, nenit 38 (paragrafi 1, 2 dhe 3), nenit 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45, 46, 47, 48, 49, 50, 51, 52, 53, 54, 55, nenit 56 (paragrafi 1, 2 dhe 3), 57 (paragrafi 2), nenit 58 (paragrafi 2), nenit 59, 60, nenit 61 (paragrafi 2 dhe 3), nenit 62, nenit 63 (paragrafi 1 dhe 3), nenit 64, 65, 66, 67, 68, nenit 70 (paragrafi 1), nenit 72 (paragrafi 6 dhe 8) të kësaj rregullore.
2. Personin fizik që ushtron biznes individual gjobitet me gjobë nga pesëdhjetë (50) euro, dhe jo me shumë se tremijë (3.000) euro, nëse: shkel dispozitat e nenit 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, nenit 22 (paragrafi 1, 2 dhe 3), nenit 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, nenit 38 (paragrafi 1, 2 dhe 3), nenit 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45, 46, 47, 48, 49, 50, 51, 52, 53, 54, 55, nenit 56 (paragrafi 1, 2 dhe 3), 57 (paragrafi 2), nenit 58 (paragrafi 2), nenit 59, 60, nenit 61 (paragrafi 2 dhe 3), nenit 62, nenit 63 (paragrafi 1 dhe 3), nenit 64, 65, 66, 67, 68, nenit 70 (paragrafi 1), nenit 72 (paragrafi 6 dhe 8) të kësaj rregullore.
3. Personi juridik gjobitet me gjobë nga (150) euro, dhe jo me shumë se dhjetëmijë (10.000) euro, nëse: shkel dispozitat e nenit 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, nenit 22 (paragrafi 1, 2 dhe 3), nenit 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, nenit 38 (paragrafi 1, 2 dhe 3), nenit 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45, 46, 47, 48, 49, 50, 51, 52, 53, 54, 55, nenit 56 (paragrafi 1, 2 dhe 3), 57 (paragrafi 2), nenit 58 (paragrafi 2), nenit 59, 60, nenit 61 (paragrafi 2 dhe 3), nenit 62, nenit 63 (paragrafi 1 dhe 3), nenit 64, 65, 66, 67, 68, nenit 70 (paragrafi 1), nenit 72 (paragrafi 6 dhe 8) të kësaj rregullore.

**Neni 77**  
**Mbledhja e mjeteve**

Mjetet e mbledhura nga zbatimi i kësaj rregullore derdhen në Buxhetin e Komunës së Gjakovës.

**Neni 78**  
**Dispozitat shfuqizuese**

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja Nr. 4 për Rregullimin e Qytetit dhe Shërbimeve Komunale-BD-DSHP/Reg/4/2002 e datës 30.01.2002 si dhe Vendimi Nr.01/31366/2015 i datës 29.04.2015 për Ndalimin e ekspozimit të mallit jashtë lokaleve afariste dhe në sipërfaqe publike.

**Neni 79**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjakovës dhe 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit te Pushtetit Lokal, si dhe shtate (7) ditë pas publikimit në ueb faqen e komunës.

